

VENDIM
Nr. 275, datë 12.5.2021

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR MARRJEN E MOSTRAVE DHE
KRYERJEN E ANALIZAVE LABORATORIKE TË NEVOJSHME PËR
KONTROLLIN E KRIPËS SË JODIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa për marrjen e mostrave për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën ushqimore të jodizuar është 8 500 (tetë mijë e pesëqind) lekë.
 2. Tarifa për kryerjen e analizave laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën ushqimore të jodizuar është 4 000 (katër mijë) lekë.
 3. Tarifa, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përfshin koston e transportit dhe koston e analizimit të mostrës së kripës ushqimore të jodizuar në laboratorët e brendshëm të saj, kur marrja e mostrës së kripës ushqimore të jodizuar, sipas procedurës realizohet nga struktura rajonale e shëndetësisë në pikën e prodhimit apo në pikat doganore (degët doganore kufitare).
 4. Tarifa, në rast kërkesë për përsëritje të analizës laboratorike nga subjektet prodhuese ose importuese, është e njëjtë me vlerën e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe